22. Vlerësimi i ofertave dhe korigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta

1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti/enti i korigjon këto gabimesi më poshtë:

- (a) Nëse ka një mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit për njësi me sasinë, çmimi për njësi do të mbizotërojë dhe çmimi total do të ndryshohet përkatësisht.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje në çmimin total, kur totali është shuma ose diferenca e nën-totaleve, çmimi nën-total mbizotëron dhe çmimi total korigjohet bazuar në të.
- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis fjalëve dhe numrave, shuma me fjalë do të mbizotërojë. Përjashtim nga ky rregull është situata kur shuma ka të bëjë me gabimin, i cili do të korigjohet sipas pikave (a) dhe (b) më lart, prandaj në këtë rast shuma në numër mbizotëron dhe ajo me fjalë do të korigjohet.
- (d) Nëse ekziston një mospërputhje midis fjalëve dhe shifrave, shuma me fjalë do të mbizotërojë, përveç nëse shuma e shprehur me fjalë lidhet me një gabim aritmetik, rast në të cilin shuma në shifra do të mbizotërojë në bazë të (a) dhe (b) më sipër.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- vlera absolute e të gjitha korigjimeve është më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- vlera absolute e të gjitha korigjimeve është më pak se 2%, por korigjimi nuk pranohet nga ofertuesi.

2. Kur autoritetet /entet kontraktore vërejnë se oferta është anomalisht e ulët, i kërkojnë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin dhe në përputhje me dispozitat e këtij neni.

- Në rast kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët kur zvogëlohet më shumë se 25% të fondit limit të përlogaritur.

- Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më pak se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, para se të marrë një vendim për kualifikimin e tyre ose jo, në përputhje me nenin 93 të LPP-së.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin / elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N

PR = 85 % Mo

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

**Kuadër/
Kontratës**

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) garanci bankare
- b) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT**25. Procedura e
ankesës**

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
2. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS**26. Anulimi i
procedurës**

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 te LPP dhe nenin 75 te VKM 285/2021.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 1/1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 7. Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 8. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 9 : Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 10 Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

Shtojca 11- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 12 : Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]**;

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]**;

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 1/1.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant per ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët]

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE**Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

*[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik]
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]*

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet)*: Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit/entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkreisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

LOTI I-RË: "BLERJE MJETE TRANSPORTI (DY KAMIONA, TRE KAMIONÇINA DHE NJË KAMION ME VINC)"

1- Kamion 4 aksial 20 m³ vetëshkarkues duhet të jetë me parametrat si më poshtë:

- | | |
|----------------------------|--------------------------|
| • Viti i prodhimit: | Jo më herët se viti 2020 |
| • Kilometra të përshkuara: | I ri (me 0 km) |
| • Fuqia e motorrit: | Minimumi 440 hp |
| • Lënda djegëse: | Naftë |
| • Akse: | 8x4 |
| • Sistemi i frenimit: | ABS |
| • Trasmisioni: | Manuale |
| • Cilindra: | 6 |
| • Karrocëria: | Vetëshkarkuese |
| • Gjatësi totale e mjetit: | Minimumi 6 m |
| • Gjerësi totale e mjetit: | Minimumi 2.3m |
| • Numri i vendeve: | Minimumi 2 |
| • Standarti i emetimit: | Euro 6 |

-
- Peshëmbajtja totale: Minimumi 40000 kg
 - Volumi: 20 m³
 - Pozicionimi i timonit: Krahu i majtë

2- Kamioçinë vetëshkarkuese dopjo gabinë 3.5 ton duhet të jetë me parametrat si më poshtë:

- Viti i prodhimit: Jo më herët se viti 2010
- Fuqia motorike: Minimumi 135 hp
- Kilometrazhi: Jo më shumë se 200,000 km
- Lënda djegëse: Naftë
- Trasmisioni: Manuale
- Numri i marsheve: 6
- Standarti i emetimit: Minimumi Euro 4
- Gjatësia totale e mjetit: Minimumi 5.5 m
- Gjerësia totale e mjetit: Minimumi 2 m
- Numri i pasagjerëve: Minimumi 6
- Pesha maksimale me ngarkesë të plotë teknikisht e lejueshme: 3500 kg
- KarrocERIA: Vetëshkarkues
- Aksi pasëm: Dopjo gomë
- Sistemi i drejtimi: Krahu i majtë
- Timoni: Hidraulik
- Sponde: Me hapje

3- Kamioçinë vetëshkarkuese tek gabinë 3.5 ton duhet të jetë me parametrat si më poshtë:

- Viti i prodhimit: Jo më herët se viti 2010
- Kilometrazhi: Jo më shumë se 200,000 km
- Lënda djegëse: Naftë
- Fuqia motorrike: Minimumi 135 hp
- Trasmisioni: Manuale
- Numri i marsheve: 6
- Standarti i emetimit: Minimumi Euro 4

• Karroceria:	Vetëshkarkuese
• Gjatësia totale e mjetit:	Minimumi 5.5 m
• Gjerësia totale e mjetit:	Minimumi 2 m
• Numri i pasagjerëve:	Min 2
• Masa maksimale me ngarkesë të plotë teknikisht e lejueshme:	3500 kg
• Aksi pasëm:	Dopjo gomë
• Sistemi i drejtimit:	Krahu i majtë
• Timoni:	Hidraulik
• Sponde:	Me hapje

4- Kamion 2-3 aksial vetëshkarkues me vinç + 4 ton duhet të jetë me parametrat si më poshtë:

• Viti i prodhimit:	Jo më herët se viti 2004
• Kilometra të përshkruara:	Jo më shumë se 250 000 Km
• Fuqia:	Jo më pak se 220 Kw
• Lënda djegëse:	Naftë
• Numri i akseve:	(2-3), 4x4
• Gomat e aksit mbrapa:	Dopjo gomë
• Kabina:	E shkurtër
• Trasmisioni:	Manuale
• Karroceria:	Vetëshkarkuese
• Gjatësia totale e mjetit:	Minimumi 8.5
• Gjerësia totale e mjetit:	Minimumi 2.4
• Numri i vendeve:	Minimumi 2
• Kapaciteti i kazanit:	Minimumi 6 m ³
• Standarti i emetimit:	Minimumi euro 4
Vinçi:	
• Gjatësia e hapjes:	Minimumi 10 m,
• Numri i hapjeve:	Minimumi 3
• Pesha mbartëse:	Minimum 4 ton në bigën e parë dhe minimumi 600 kg në hapjen e plotë.

-Mjetet objekt i procedurës së prokurimit, të jenë të pajisur me të gjithë dokumentacionin teknik dhe ligjor shoqërues, për qarkullimin dhe përdorimin e tyre, sipas legjislacionit shqiptar dhe standardeve kombëtare e ndërkombëtare. Në çmimin e secilit prej mjeteve objekt i kësaj procedure prokurimi, duhet të përfshihen të gjitha shpenzimet për taksat doganore, regjistrimi, siguracioni, targat, kontrolli teknik, taksa, shpenzime noteriale për kalimin e pronësisë, etj (sipas rastit), si dhe çdo shpenzim tjetër në funksion të qarkullimit të tyre, siç përcaktohen në Ligjin nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, si edhe akteve të tjera nënligjore që rregullojnë këtë fushë të veprimtarisë, deri në dorëzimin e tyre në destinacionin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

-Mjetet duhet të jene te mbuluar me nje garanci teknike minimumi **1 vit**, nga dita e marrjes ne dorezim te tyre. Kjo garanci teknike eshte kerkuar, per arsye se, gjate puneve te ndryshme qe mjetet do te zhvillojne gjate ketij afati kohor prej minimumi 1 vit, eshte gjykuar si e arsyeshme qe eshte koha e mjaftueshme per testimin teknik te mjeteve.

-Mjetet duhet te dorezohen me te gjitha sherbimet teknike te kryera (vaj, filtra, etj.)

Vendi i ekzekutimit të kontratës: Në magazinën e Bashkisë Divjakë.

Shënim: Mjetet e përdorura (me kilometrazh/ore pune më shumë se 0):

Mjetet duhet të jenë në gjendje shumë të mirë motorike, xhenerike dhe vizuale në pjesën e brendshme/jashtme dhe duke mos pasur dëmtime sidomos për sa i përket korrozionit, dëmtimet nga agjentët atmosferikë, goditjet etj. Tubat e presionit te vajit, te jene ne gjendje te mire (te pa gripuara). Gomat te jene ne gjendje te mire (jo te konsumuara).

Mjetet e perdorura objekt i procedures se prokurimit do të pranohen (do te merren në dorëzim përfundimtar pas kolaudimit), nga nje komision i posacem i ngritur nga autoriteti kontraktor, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

-Afati i kolaudimit do te jete (prova, testime ne terren) jo me shume se 7 dite kalendarike ose 5 dite pune.

Afati i lëvrimit: Për Loti I-rë: “Blerje mjete transporti (dy kamiona, tre kamionçina dhe një kamion me vinç)” është 2 muaj nga momenti i nënshkrimit të kontratës.

Artikulli	Përshkrimi	Sasia	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	Kamion 4 aksial 20 m ³ vetëshkarkues	2	Në magazinën e Bashkisë Divjakë	2 muaj nga momenti i nënshkrimit të kontratës
2	Kamioçinë vetëshkarkuese dopjo gabine 3.5 ton	2	Në magazinën e Bashkisë Divjakë	2 muaj nga momenti i nënshkrimit të kontratës
3	Kamioçinë vetëshkarkuese tek gabine 3.5 ton	1	Në magazinën e Bashkisë Divjakë	2 muaj nga momenti i nënshkrimit të kontratës
4	Kamion 2-3 aksial vetëshkarkues me vinç + 4 ton	1	Në magazinën e Bashkisë Divjakë	2 muaj nga momenti i nënshkrimit të kontratës

⇒ **Argumentimi i specifikimeve teknike te mjeteve perkatesisht si me poshte:**

1) Konkretisht për mjetin Kamion 4 aksial 20 m³ vetëshkarkues, grupi i punës i caktuar me urdher për hartimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike argumenton të specifikimet teknike se:

Pika 1-2-13- Është përcaktuar që mallrat objekt prokurimi të jenë të reja, të papërdorura, ku viti i prodhimit të jetë jo më parë se 2020 (që në fakt bëhet fjalë për një periudhë të arsyeshme që përfshin 5 (pese) vite prodhimi 2020, 2021, 2022, 2023, 2024). Kjo është kërkuar që mjetet e kërkuara, të jenë të prodhimit të viteve të fundit, në mbështetje edhe të pikës 8/b të V.K.M nr.633 datë 16.10.2018 “Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorrike” në përputhje të plotë me legjislacionin kombëtar dhe direktivave të BE për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis, në varësi të kategorizimit të mjeteve, sipas peshës dhe kohës së përdorimit. Këto mjete bëjnë pjesë në gjeneratën e re në drejtim të ekonomisë së karburantit, sigurisë dhe qëndrueshmërisë teknike, efikasitetit dhe efikasitetin në koston e përgjithshme, sigurinë dhe mbrojtjen e mjedisit si edhe në rregullimin dhe emëtimin e gazrave në natyrë.

Pika 3-5- Kerkohet minimumi fuqia 440 hp për arsyen se mjetet në këtë fuqi kanë rendiment më të lartë për ngarkesën e kërkuar, dhe akse 8x4 për një qëndrueshmëri të lartë të mjetit një ballancim uniform të ngarkesës në terrene të vështira.

Pika 4- Për këtë procedurë për llojin e karburantit është zgjedhur lënda djegëse “Naftë”, për shkak se dallimi kryesor në mes të motorëve me naftë dhe me benzinë është efikasiteti termik që motorët me naftë kanë. Motorri me naftë është 20% më efikas sesa motorrat me benzinë, gjë që ndikon drejtpërdrejtë me rritjen e ekonomisë së karburantit në 20%. Arsye tjetër se përse për këtë procedurë është zgjedhur lënda djegëse “Naftë” është dhe tipologjia e mjetit. Duke qënë se janë mjete të rënda dhe janë të presupozuara të punojnë në terrene të vështira dhe kërkojnë një forcë motorrike të konsiderueshme është përzgjedhur lënda djegëse “Naftë” dhe për arsye të fuqisë kalorifike që ajo ka (më të lartë se benzina). Gjithashtu duke testuar edhe tregun përgjithësisht për mjetet e rënda lënda djegëse është “Naftë”. Motorri me naftë është më i thjeshtë, ka më shumë qëndrueshmëri dhe jetëgjatësi më të lartë.

Pika 6- Sistemi ABS- Anti-lock Brake System ose në shqip sistemi që nuk e lejon gomën të bllokohet plotësisht. ABS na ndihmon në situatën e një frenimi të fortë ku në rastin e një makine pa abs goma do bllokohej 100% nga freni dhe mundësia për të manovruar me anë të timonit humbet totalisht duke qënë se goma nuk ka më aftësinë rrotulluese për të bërë të mundur drejtimin. Në rastin kur mjeti është i pajisur me sistemin ABS gjatë një frenimi të fortë ABS nuk na lejon që goma të bllokohet kjo i jep shoferit mundësinë që dhe të frenojë në maksimum por dhe të shmangët duke përdorur timonin.

Pika 7- Transmesioni manual është në mjetet e rënda ku këto transmesione kanë një përdorim të shumicës për shkak të efikasitetit të tyre të fillimit për të ngarkuar ose tërhequr një peshë me një shpejtësi të caktuar, të shoqëruara nga mbështetëse të tilla si një motor elektrik së bashku me një të ashtuquajtur konvertues çift rrotullues të dyfishtë, si dhe një motor frenues që mund të parandalojë dëmtimin e transmetimit në ndalesa të papritura. Transmesioni manual i garanton shoferit kontrollin e plotë mbi marshin kur do të bëjë ndërrimet. Mjetet me transmesioni manual kushtojnë më pak, edhe kanë koston më të ulët mirëmbajtjeje në krahasim me mjetet me transmesion automatik.

Pika 8- Motorri me 6 cilindrat prodhon me shumë fuqi/moment. Motorri ka punim të qetë me pak zhurma në kabine edhe efikasitet në konsum.

Pika 9- Karrocëria duhet vetëshkarkuese për të lehtësuar punën dhe kursim kohë.

Pika 10-11- Permasat e mjetit i referohen plotësisht të kapacitetit mbajtës.

Pika 12- Minimumi 2 vende per arsye se duhet te kete edhe nje vend per nje ndihmes(shofer/punetor).

Pika 14-15- Minimumi i peshes 40,000 kg eshte vendosur per arsye te transportimit te kategorive te ndryshme te inerteve, per nje volum prej 20m³.

Pika 16- Pozicionimi i timonit duhet te jete i majte per tu pershtatur legjislacionit rrugor Shqiptar.

2) Per mjetin Kamioncine veteshkarkuese dopjo gabine 3.5 ton, grupi i punes i caktuar me urdher per hartimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike argumenton te specifikimet teknike se:

Pika 1- Per percaktimin e vitit te prodhimit u bazua te buxheti dhe ne studimit te tregut.

Pika 2- Kerkohet minimumi fuqia 135 hp per arsyen se mjetet ne kete fuqi kane rendiment me te larte per punen e kerkuar.

Pika 3- Kilometrazhi jo me shume se 200,000 km per arsye se mjeti nuk eshte konsumuar, amortizuar shume.

Pika 4- Për këtë procedurë, për llojin e karburantit është zgjedhur lënda djegëse “Naftë”, për shkak se dallimi kryesor në mes të motorrëve me naftë dhe me benzinë është efikasiteti termik që motorrët me naftë kanë. Motorri me naftë është 20% më efikas sesa motorrat me benzinë, gjë që ndikon drejtë për drejtë me rritjen e ekonomisë së karburantit në 20%. Gjithashtu duke iu referuar edhe testimi të tregut, përgjithësisht për keto mjete lënda djegëse është “Naftë”.

Pika 5- Transmesioni manual i garanton shoferit kontrollin e plotë mbi marshin kur do të beje ndërrimet. Mjetet me transmesioni manual kushtojne me pak, edhe kane kosto me te ulet mirembajtje ne krahasim me mjetet me transmesion automatik.

Pika 6- Numri i marsheve 6 per arsye se efienca e mjetit motorrik eshte me e larte dhe konsumi eshte me i vogel.

Pika 7- Euro 4 per arsye te reduktimit te emetimit te gazrave ne natyre.

Pika 8-9- Gjatesia jo me e vogel se 5.5 m dhe gjersia jo me e vogel se 2 m per arsye te lehtesirave te trasportimit te mallrave dhe mundesi shfrytezimi me shume te mjetit.

Pika 10- Per arsye te trasportimit me te lehte dhe te shpejt te punonjesve ne vendin e punes.

Pika 11- Pesha 3500kg per arsye te lehtesirave te perdorimit te mjetit pasi mund te drejtohet me patent te klasit B.

Pika 12- Karrocera duhet veteshkarkuese per te lehtesuar punen dhe kursim kohe.

Pika 13- Dopolio gome per qendrueshmeri me te larte te mjetit ne terrene te veshtira dhe lehtesi ne mbajtje te ngarkeses.

Pika 14- Pozicionimi i timonit duhet te jete i majte per tu pershtatur legjislacionit rrugor Shqiptar.

Pika 15- Per manovrueshmeri me te lehte te sistemit te drejtimit.

Pika 16- Per lehtesi dhe efikasitet ne pune.

3) Per mjetin Kamioncine veteshkarkuese tek gabine 3.5 ton grupi i punes i caktuar me urdher per hartimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike argumenton te specifikimet teknike se:

Pika 1- Per percaktimin e vitit te prodhimit u bazua te buxheti dhe ne studimit te tregut.

Pika 2- Kilometrazhi jo me shume se 200,000 km per arsye se mjete nuk eshte konsumuar, amortizuar shume.

Pika 3- Për këtë procedurë, për llojin e karburantit është zgjedhur lënda djegëse “Naftë”, për shkak se dallimi kryesor në mes të motorëve me naftë dhe me benzinë është efikasiteti termik që motorët me naftë kanë. Motorri me naftë është 20% më efikas sesa motorrat me benzinë, gjë që ndikon drejtë për drejtë me rritjen e ekonomisë së karburantit në 20%. Gjithashtu duke iu referuar edhe testimi të tregut, përgjithësisht për këto mjete lënda djegëse është “Naftë”.

Pika 4- Kerkohet minimumi fuqia 135 hp per arsyen se mjetet ne kete fuqi kane rendiment me te larte per punen e kerkuar.

Pika 5- Transmesioni manual i garanton shoferit kontrollin e plotë mbi marshin kur do të beje ndërrimet. Mjetet me transmesioni manual kushtojne me pak, edhe kane kosto me te ulet mirembajtje ne krahasim me mjetet me transmesion automatik.

Pika 6- Numri i marsheve 6 per arsye se eficenca e mjetit motorrik eshte me e larte dhe konsumi eshte me i vogel.

Pika 7- Euro 4 per arsye te reduktimit te emetimit te gazrave ne natyre.

Pika 8- KarrocERIA duhet veteshkarkuese per te lehtesuar punen dhe kursim kohe.

Pika 9-10- Gjatesia jo me e vogel se 5.5 m dhe gjersia jo me e vogel se 2 m per arsye te lehtesirave te trasportimit te mallrave dhe mundesi shfrytezimi me shume te mjetit.

Pika 11- Minimumi 2 vende per arsye se duhet te kete edhe nje vend per nje ndihmes (shofer/punetor).

Pika 12- Pesha 3500kg per arsye te lehtesirave te perdorimit te mjetit pasi mund te drejtohet me patent te klasit B.

Pika 13- Doppio gome per qendrueshmeri me te larte te mjetit ne terrene te veshtira dhe lehtesi ne mbajtje te ngarkeses.

Pika 14- Pozicionimi i timonit duhet te jete i majte per tu pershtatur legjislacionit rrugor Shqiptar.

Pika 15- Per manovrueshmeri me te lehte te sistemit te drejtimit.

Pika 16- Per lehtesi dhe efikasitet ne pune.

4) Per mjetin Kamion 2-3 aksial veteshkarkues me vinc +4 ton grupi i punes i caktuar me urdher per hartimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike argumenton te specifikimet teknike se:

Pika 1- Per percaktimin e vitit te prodhimit u bazua te buxheti dhe ne studimit te tregut.

Pika 2- Kilometrazhi jo me shume se 250.000 km per arsye se mjete nuk eshte konsumuar, amortizuar shume.

Pika 3- Kerkohet minimumi fuqia 220 kw per arsyen se mjetet ne kete fuqi kane rendiment me te larte per punen e kerkuar

Pika 4- Për këtë procedurë, për llojin e karburantit është zgjedhur lënda djegëse “Naftë”, për shkak se dallimi kryesor në mes të motorëve me naftë dhe me benzinë është efikasiteti termik që motorët me naftë kanë. Motorri me naftë është 20% më efikas sesa motorrat me benzinë,

gjë që ndikon drejtë për drejtë me rritjen e ekonomisë së karburantit në 20%. Arsye tjetër se përse është zgjedhur karburanti “Naftë” është edhe tipologjia e mjetit. Duke qënë se është mjet i rëndë dhe është i presupozuar të punojë në terrene të vështira dhe kërkon një forcë motorrike të konsiderueshme, është përzgjedhur lëndja djegëse “Naftë” dhe për arsye të fuqisë kalorifike që ajo ka (më të lartë se benzina). Gjithashtu duke iu referuar edhe testimit të tregut, përgjithësisht për mjetet e rënda lënda djegëse është “Naftë”.

Pika 5- Numri i akseve (2-3) dhe mjeti (4x4) aktive për përdorimin e mjetit në terrene të vështira.

Pika 6- Dopolio gome për qëndrueshmëri me të lartë të mjetit në terrene të vështira dhe lehtësi në mbajtje të ngarkesës.

Pika 7- Arsye manovrimi me të lehtë të mjetit,

Pika 8- Transmesioni manual i garanton shoferit kontrollin e plotë mbi marshin kur do të beje ndërrimet. Mjetet me transmesioni manual kushtojnë më pak, edhe kanë kosto më të ulët mirëmbajtjeje në krahasim me mjetet me transmesion automatik.

Pika 9- Karrocëria duhet vetshkarkuese për të lehtësuar punën dhe kursim kohë.

Pika 10-11- Gjatesia jo më e vogël se 8.5 m dhe gjersia jo më e vogël se 2.4 m për arsye të lehtësirave të transportimit të mallrave dhe mundësi shfrytëzimi me shumë të mjetit.

Pika 12- Minimumi 2 vende për arsye se duhet të ketë edhe një vend për një ndihmes (shofer/punëtor)

Pika 13- Permasat e mjetit i referohen plotësisht të kapacitetit mbajtës.

Pika 14- Euro 4 për arsye të reduktimit të emetimit të gazrave në natyrë.

Pika 15-16- Materialet e transportuara të lihen në destinacionin përkatës edhe aty ku mjeti nuk arrin.

Pika 17- Mundësia më e madhe e transportimit të materialeve të ndryshme në peshe.

Shënim: Në respektim të nenit 36 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të gjitha rastet kur përmendet “markë” pranohet termi “ose ekuivalent i tij/i saj”.

LOTI II-TË: “BLERJE MJETE GËRRMIMI (NJË ESKAVATOR AMFIB, NJË ESKAVATOR ME GOMA, NJË MINIESKAVATOR DHE NJË FADROMË)”

1. Eskavatori me goma me kova të ndryshme duhet të jetë me parametrat si më poshtë:

- | | |
|------------------------|--------------------------------|
| • Viti i prodhimit: | Jo më herët se 2020 |
| • Orët e punës: | I ri (0 orë) |
| • Rendimenti i Fuqisë: | Minimumi 130 hp |
| • Pesha e mjetit: | 15 ton - 18 ton |
| • Norma e emetimit: | Minimumi Tier 4 finale/Stage V |
| • Lartësia në gjërmim: | Minimumi 10m |

- Thellësia në gërmim: Minimumi 5.5 m
- Zgjatja horizontale: Minimumi 9 m
- Eskavatori të jetë i pajisur me 2 kova dhe me 1 korrëse për pastrim/prerje vegjetacioni.

Kovat:

Kova e gërmimit të jetë me vëllim minimumi 0.75m³.

Kova e pastrimit të kanaleve me pistona: të jetë e gjerë të paktën 180cm, me vëllim të paktën 0.6m³.

Korresja:

- Korresja për pastrim/prerje vegjetacioni: të jetë e gjere të paktën 180 cm dhe të presë vegjetacion me diameter deri në 10 cm.
- Krahu i eskavatorit të jetë i pajisur me linja hidraulike për vegla të ndryshme pune dhe kapje të shpejtë.
- Eskavatori të jetë i pajisur me thike përpara, dhe me stabilizues hidraulik mbrapa, me autolubrifikim, me kamera për mbrapa dhe anash, me A/C.
- Eskavatori të jetë i pajisur me transmetues për monitorimin e mjetit në distancë.

2. Eskavatori amfib për mirëmbajtjen e lagunës duhet të jetë me parametrat si më poshtë:

- Viti i prodhimit: Jo më herët se 2020
- Orët e punës: I ri (0 orë)
- Fuqia: Minimumi 170 hp
- Peshë e mjetit: 36 ton – 40 ton
- Norma e emetimit: Minimumi Tier 4 finale/Stage V

Krahu:

- Lartësia në gërmim: Minimumi 14.5 m
- Thellësia në gërmim përpara: Minimumi 10 m
- Thellësia në gërmim pozicion anash: Minimumi 8.5 m
- Hapja maksimale horizontale e krahut: Minimumi 15.5

Kovat:

Të jetë i pajisur me 2 kova:

- Kova për gërmim: Minimumi 0.5m³
- Kova për pastrim kanalesh: Minimumi 0.5m³ dhe gjerësi minimale 180cm

-Struktura amfibe:

- Kapaciteti i përgjithshëm lundruës i pontonit: Minimumi 37 ton
- Minimumi 2 motorra ecje për ane (4 në total), të jetë teknologji e patentuar, motorrat hidraulik multisinkron me ngasje direkte.
- Hapje/pusete në ponton në mënyrë që mund të hyjë personel për mirëmbajtje.
- Zinxhirat duhet të kenë mundësi të zgjerohen në modalitet pune dhe të ngushtohen në modalitet transporti mekanikisht ose hidraulikisht.
- Gjerësia maksimale e zinxhirëve poshtë kur zgjerohen/hapen duhet të jetë të pakten 5.9 m.
- Gjerësia maksimale e zinxhireve poshtë kur ngushtohen duhet të jetë maksimalisht 4.5m
- Largësia nga toka e struktures amfibe: Minimumi 1.3m
- Lartësia e pontonit/zinxhirit: Minimumi 2m
- Gjatësia e zinxhireve amfibe: Maksimumi 10m
- Të ketë aftësi për të punuar në thellësi uji 1.5 m.
- Dizajni i pontonit kryesor duhet të ketë dispozite për shtimin e pontonit shtesë dhe sistemit të pluskimit me funksion hidraulik nëse lind nevoja në fazë të mevonshme për operim në ujra më të thella.
- Krahu i eskavatorit të jetë i pajisur me linja hidraulike për vegla të ndryshme pune, me drita pune nga të gjitha anët, me kamera për mbrapa dhe anash, me ekran monitor minimumi 10", me A/C.
- Eskavatori të jetë i pajisur me transmetues për monitorimin e mjetit në distancë.

3. Fadromë e re duhet të jetë me parametrat si më poshtë:

- Viti i prodhimit: Jo më herët se viti 2020
- Orë pune: I ri (0 orë)
- Mënyra e lëvizjes: Me goma
- Pesha e mjetit: 8 ton - 11 ton
- Rendimenti i fuqisë: Minimumi 70 kw
- Lënda djegëse: Naftë
- Norma e emetimit: Minimumi Tier 3

Krahu:

- Lartësia max operative: Minimumi 6m
- Thellësia e gërmimit: Minimumi 5.5m
- Zgjatja maksimale horizontale nga aksi i gomave te pasme: Minimumi 7.5m

Kovat:

- E pajisur me 3 kova gërmimi me dimensione: {30-40cm dhe 60-70cm dhe 90-100cm}

- Kova përpara multifunktionale që hapet me kapacitet minimumi 1m³. Kova përpara të jetë e pajisur edhe me dhëmbë piruni.

- E pajisur me kapje të shpejte për krahun mbrapa, me stabilizues hidraulik, me A/C.

- Fadroma të jetë e pajisur me transmetues për monitorimin e mjetit në distancë.

4. Minieskavator 6-7 ton duhet të jetë me parametrat si më poshtë:

• Viti i prodhimit:	Jo më herët se viti 2020
• Orët e punës:	I ri (0 orë)
• Rendimenti i Fuqisë:	Minimumi 40 kw
• Pesha e mjetit:	6 ton - 7 ton
• Lënda djegëse:	Naftë
• Norma e emetimit:	Minimumi Tier 4 finale/Stage V
• Mënyra e lëvizjes:	Zinxhir gome

Krahu:

• Lartësia në gërmim:	Minimumi 6m
• Thellësia në gërmim:	Minimumi 4 m
• Zgjatja maksimale horizontale:	Minimumi 6.5m
• Rrotullimi i krahut majtas:	Minimumi 55 grad
• Rrotullimi i krahut djathtas:	Minimumi 60 grad

Kovat:

E pajisur me 2 kova gërmimi me dimensione: {30-40cm dhe 60-70cm}

E pajisur me 1 kovë pastrimi kanalesh me dimension: {100-160cm}

- Minieskavatori të jetë i pajisur me linja hidraulike për vegla të ndryshme pune, me kapje të shpejtë, me valvula sigurie te pistonat e krahëve, me thikë përpara, me kamera për mbrapa, me A/C.

- Minieskavatori të jetë i pajisur me transmetues për monitorimin e mjetit ne distancë.

-Mjetet objekt i procedurës së prokurimit, të jenë të pajisur me të gjithë dokumentacionin teknik dhe ligjor shoqërues, për qarkullimin dhe përdorimin e tyre, sipas legjislacionit shqiptar dhe standardeve kombëtare e ndërkombëtare. Në çmimin e secilit prej mjeteve objekt i kësaj procedure prokurimi, duhet të përfshihen të gjitha shpenzimet për taksat doganore, regjistrimi, siguracioni, targat, kontrolli teknik, taksa, shpenzime noteriale për kalimin e pronësisë, etj (sipas rastit), si dhe çdo shpenzim tjetër në funksion të qarkullimit të tyre, siç përcaktohen në Ligjin nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, si edhe akteve të tjera nënligjore që rregullojnë këtë fushe të veprimtarisë, deri në dorëzimin e tyre në destinacionin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

-Mjetet duhet te jene te mbuluar me nje garanci teknike minimumi **1 vit**, nga dita e marrjes ne dorezim te tyre. Kjo garanci teknike eshte kerkuar, per arsye se, gjate puneve te ndryshme qe mjetet do te zhvillojne gjate ketij afati kohor prej minimumi 1 vit, eshte

gjykuar si e arsyeshme qe eshte koha e mjaftueshme per testimin teknik te mjeteve.

-Mjetet duhet te dorëzohen me te gjitha sherbimet teknike te kryera (vaj, filtra, etj.)

Vendi i ekzekutimit të kontratës: Në magazinën e Bashkisë Divjakë.

Afati i lëvrimit: Për Loti II-të: “Blerje mjete gërrmimi (një eskavator amfib, një eskavator me goma, një minieskavator dhe një fadromë)” është 7 muaj nga momenti i nënshkrimit të kontratës.

Artikulli	Përshkrimi	Sasia	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	Eskavator me goma me kova të ndryshme	1	Në magazinën e Bashkisë Divjakë	7 muaj nga momenti i nënshkrimit të kontratës
2	Eskavator amfib për mirëmbajtjen e lagunës	1	Në magazinën e Bashkisë Divjakë	7 muaj nga momenti i nënshkrimit të kontratës
3	Fadrom e re	1	Në magazinën e Bashkisë Divjakë	7 muaj nga momenti i nënshkrimit të kontratës
4	Minieskavator 6-7 ton	1	Në magazinën e Bashkisë Divjakë	7 muaj nga momenti i nënshkrimit të kontratës

⇒ **Argumentimi i specifikimeve teknike te mjeteve perkatesisht si me poshte:**

1) Konkretisht per mjetin Eskavator me goma me kova te ndryshme, grupi i punes i caktuar me urdher per hartimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike argumenton te specifikimet teknike se:

Pika 1-2-5- Është përcaktuar që mallrat objekt prokurimi të jenë të reja, të papërdorura, ku viti i prodhimit të jetë jo më parë se 2020 (që në fakt bëhet fjalë për një periudhë të arsyeshme që përfshin 5 (pese) vite prodhimi 2020, 2021, 2022, 2023, 2024). Kjo është kërkuar që mjetet e kërkuara, të jenë të prodhimit të viteve të fundit, në mbështetje edhe të pikës 8/b të V.K.M nr.633 datë 16.10.2018 “Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorrike” në përputhje të plotë me legjislacionin kombëtar dhe direktivave të BE për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis, në varësi të kategorizimit të mjeteve, sipas peshës dhe kohës së përdorimit. Këto mjete bëjnë pjesë në gjeneratën e re në drejtim të ekonomisë së karburantit, sigurisë dhe qëndrueshmërisë teknike, efikasitetit dhe efikasitetin në koston e përgjithshme, sigurinë dhe mbrojtjen e mjedisit si edhe në rregullimin dhe emëtimin e gazrave në natyrë.

Pika 3- Kerkohet minimumi fuqia 130 hp per arsyen se mjetet ne kete fuqi kane rendiment me te larte per punen e kerkuar.

Pika 4- Pesha ndikon ne qendrueshmerine aftesine ngritese dhe pershtatshmerine e mjetit ne terrene te ndryshme.

Pika 6-7-8- Pershtatet objektive te punes, terreneve ku mjete do te punoje.

Pika 9- Volume të ndryshme të kovave, për arsye të punimit të skarpatave të sistemit të vaditjes nga të dyja faqet e saj.

Pika 10- Nevojitet për pastrimin e vegetacionit në ane të rrugëve, skrapatave të kanaleve, si dhe krasitjen e degeve të pemëve deri në 10 cm diametër.

Pika 11-12-13- Pajisja e krahut të mjetit me linjë të ndryshme hidraulike dhe me kapje të shpejta jep mundësi manovratorit që të mund të përdorë vegla të ndryshme pune dhe ndërrim të shpejtë të veglave pa qenë nevoja që të zbrese nga mjete për zëvendësimin e tyre.

Për të pasur një stabilitet më të mirë gjatë punës duhet mjete të fiksohet në vend me ane të stabilizuesve hidraulik dhe thikës përpara.

Kërkohej që lubrifikimi të jetë automatik për një lubrifikim më të mirë dhe të shpejtë të mjetit gjatë punës.

Pajisja me kamerë mbrapa dhe anash mjetit i jep një kontroll më të mirë dhe siguri më të lartë gjatë punës në terrene ku kontrolli i mjetit bëhet i vështirë me sy të lirë.

Për komoditet të manovratorit, duke qenë se mjete mund të punojnë në ambiente me temperatura të larta ose të ulta kërkohej të jetë i pajisur me A/C.

